

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar së bashku nga Daimler Trak AG me seli të regjistruar në Fazanenveg 10, 70771 Lajnfelden-Ehterdingen-Gjermani, BLEKROK FAJNENSHAL MANAXHMENT, Inc. me seli të regjistruar në 40 East 52nd Street, New York, NY 1022, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NEKSTERA ENERXHI, INK. me zyrë të regjistruar në 700 Universe Blvd., Juno Beach, FL 33408, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e dorëzuar nga i autorizuari BozHidar Millosheviç, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 27.10.2022, solli

### **AKTVENDIM**

1. Vërtetohet se përqendrimi i cili i referohet krijimit të një sipërmarrjeje të përbashkët plotësisht funksionale që do të zhvillojë, ndërtojë, financojë, zotërojë dhe operojë me infrastrukturë të pikave/depove që janë në dispozicion për automjetet elektrike të rënda, autobusëve dhe autobusëve të transportit nga Daimler Trak AG me seli të regjistruar në Fazanenveg 10, 70771 Lajnfelden-Ehterdingen-Gjermani, BLEKROK FAJNENSHAL MANAXHMENT, Inc. me seli të regjistruar në 40 East 52nd Street, New York, NY 1022, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NEKSTERA ENERXHI, INK. me zyrë të regjistruar në 700 Universe Blvd., Juno Beach, FL 33408, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose shoqërive të tyre të lidhura, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksa administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

### **Arsyetim**

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 20.09.2022 dhe i plotësuar më 07.10.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar njoftim i përqendrimit që i referohet krijimit të një sipërmarrjeje të përbashkët plotësisht funksionale që do të zhvillojë, ndërtojë, financojë, zotërojë dhe

operojë me infrastrukturë të pikave/depove që janë në dispozicion për automjetet elektrike të rënda, autobusëve dhe autobusëve të transportit nga Daimler Trak AG me seli të regjistruar në Fazanenveg 10, 70771 Lajnfelden-Ehterdingen-Gjermani, BLEKROK FAJNENSHAL MANAXHMENT, Inc. me seli të regjistruar në 40 East 52nd Street, New York, NY 1022, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NEKSTERA ENERXHI, INK. me zyrë të regjistruar në 700 Universe Blvd., Juno Beach, FL 33408, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose shoqërive të tyre të lidhura.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim , shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve përfshirëse:

**-Daimler Trak AG** është me seli në Lajnfelden-Ehterdingen, Gjermani dhe është një shoqëri e varur 100% e Daimler Trak Holding AG. Daimler Trak AG ndërkohë që nga data 1 shkurt 2022 është riemëruar Mercedes-Benz Group AG, i cili ka vetëm pjesë pa kontroll prej 30.01% të kapitalit themelor të Daimler Trak Holding AG. Ndarja përfundoi më 9 dhjetor 2021 dhe si rezultat i këtij transaksioni, Mercedes-Benz AG dhe Daimler Trak Holding AG janë ndërmarrje të veçanta edhe me aktivitetet e tyre - Mercedes-Benz AG (makina udhëtarësh, automjete komerciale dhe aktivitete të ngjashme) dhe Daimler Trak AG (kamionë dhe autobusë të lehtë, të mesëm dhe të rëndë dhe aktivitete të ngjashme).

Daimler Trak AG nuk ka kompani të varura, filiale apo përfaqësive në Maqedoninë e Veriut. Daimler Trak AG është indirekte e pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes fushës së saj kryesore të biznesit – shitjes së automjeteve (kamionëve dhe autobusëve), përmes një distributori të pavarur të palës së tretë.

**-BLEKROK FAJNENSHAL MENAXHMENT, Inc** është një shoqëri SHBA-së, aksionet e të cilës tregtohen publikisht, duke ofruar në mënyrë aktive menaxhimin global të investimeve, menaxhimin e rrezikut dhe shërbimeve këshillimore për institucionet dhe klientët me pakicë në mbarë botën. BLEKROK FAJNENSHAL MENAXHMENT, Inc menaxhon mjetet në emër të institucioneve dhe investitorëve individualë në mbarë botën. Për më tepër, përmes BlekRok Solushns, shoqëria ofron shërbime për menaxhimin e rrezikut dhe shërbimet këshilluese që kombinojnë ekspertizën e tregut të kapitalit me sistemet dhe teknologjinë e BLEKROK FAJNENSHAL MENAXHMENT, Inc.

BLEKROK FAJNENSHAL MENAXHMENT, Inc. nuk ka shoqëri të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

**NEKSTERA ENERXHI INK** është një korporatë e themeluar sipas ligjeve të Shtetit të Floridës, SHBA me zyrën dhe selinë e saj të regjistruar në Juno Beach, Florida, SHBA. NEKSTERA ENERXHI INK është një nga shoqëritë më të mëdha të infrastrukturës së energjisë elektrike në Amerikën e Veriut dhe një udhëheqës në industrinë e energjisë rinovuese.

NEKSTERA ENERXHI INK nuk ka shoqëri të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ndërmarrja e përbashkët do të jetë e vendosur në SHBA dhe Kanada dhe kryesisht do të zhvillojë, ndërtojë, financojë, zotërojë dhe operojë me infrastrukturë që është në dispozicion publik të pikave/magazinave të mbushjes të TEV për transport të gjatë dhe rajonal përgjatë korridoreve të caktuara në Shtetet e Bashkuara kontinentale dhe Kanada.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

#### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**